

*Mbledhje e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
të datës 7.01.2021, ora 17:30*

**Seancë publike e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve**

**Rendi i Ditës:**

*Projektvendim “Për miratimin e formatit dhe specifikimeve të vulës të KZAZ-së, të vulës së KQV-së, vulës së kryetarit të KQV-së dhe të vulës rezervë të KQV-së për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021”.*

**Pjesëmarrja:**

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Stafi i KQZ: Ylli Merkaj, Ana Tenolli**

**Përfaqësuesi i PD**

**Z.I.Celibashi:** Atëherë mirëmbërëma të gjithëve, fillojmë seancën publike për shqyrtimin nga Komisioneri Shtetërorë të këtyre çështjeve. Projektvendim “për shpalljen e rezultatit të shortit për caktimin e partisë që do të propozojë anëtarin e 7- të të KZAZ-së, në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25.04.2021”. Projektvendimi “për miratimin e formatit dhe specifikimeve të vulës të KZAZ-së, të vulës së KQV-së, të vulës së kryetarit të KQV-së dhe të vulës rezervë të KQV-së për zgjedhjet në Kuvendin e Shqipërisë për datën 25.04.2021” dhe pika e 3-të e rendit të ditës është Projektvendimi “për miratimin e modeleve të specifikimeve të shenjave dalluese të logjistikës zgjedhore për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë datë 25.04.2021”. Pjesëmarrës në mbledhje janë vetëm përfaqësues të partive politike, në mënyrë të posaçme përfaqësues të Partisë Demokratike, përfaqësues të partive të tjera politike nuk kanë ardhur. Mirë atëherë fillojmë me shqyrtimin çështjeve sipas rendit të ditës.

**Z.I.Celibashi:** Vazhdojmë me pikën e rendit të ditës që ka të bëjë me miratimin e formamtit dhe specifikimeve të vulës të komisionit të zonës së administrimit



*Mbledhje e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
të datës 7.01.2021, ora 17:30*

zgjedhore, të vulës së komisionit të qendrës së votimit, të vulës të kryetarit të komisionit të qendrës së votimit dhe të vulës rezervë të komisionit të qendrës së votimit për Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25.04.2021.

**Z.Y.Merkaj:** Po referuar kryetarit të nenit 39 të Kodit Zgjedhorë, KQZ-ve dërgon në komisionet e zonave e administrimit zgjedhore dhe në Komisionet e qendrave të votimit materialet zgjedhore. Në materialet zgjedhore të përcaktuara në këtë dispozitë përfshihen vulat e KZAZ-ve, vulat e QV-së, vulat e kryetarit të QV-së dhe vula rezervë për çdo qendër votimi. Kodi zgjedhorë neni 103 ka përcaktuar dhe tekstin që do të përmbajnë këto vula. Vula e KQV-së përmban tekstin Komisioni i Qendrës së Votimit dhe numrin përkatës të qendrës së votimit, Vula e kryetarit të qendrës së votimit përmban tekstin kryetari dhe një numër serial 5-së shifror, vula rezervë taxis unik për secilen vulë është përcaktuar me vendimin e komisionit rregullator nr.11 datë 28.12.2020. Formatit dhe specifikenti i vulës së ZAZ-ve QV-ve dhe kryetarit të QV-së si dhe vulës rezervë referohet në përcaktimet e Kodit Zgjedhorë si dhe në vendimet e Këshillit të Ministrave me nr. 390 datë 06.08.1993 për rregullat e prodhimit administrimit kontrollit mbi ruajtjen e vulave zyrtare. Këto vula prodhohen në sektorin e prodhimit të vulave zyrtare pranë Ministrisë së Brendshme. Për sa më sipër brenda kompetencave të tij Komisionit Shtetëror të zgjedhjeve i propozohet për shqyrtim dhe miratim projektvendimi i mësipërm bashkëlidhur me projektvendimin paraqitet dhe lidhja nr.1 që është formati dhe specifikës ndaj vulës së KZAZ-së. Lidhja 2 formati specifikës ndaj vulës së KQV-së. Lidhja 3 formati specifikës ndaj vulës së Kryetarit të KQV-së si dhe formati specifikimit të vulës rezervë është lidhja nr.4 faleminderit.

**Z.I.Celibashi:** Faleminderit, me pak fjalë pak a shumë janë të njëjtat

2

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Albana Ndoci*



*Mbledhje e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
të datës 7.01.2021, ora 17:30*

karakteristika, teknika por dhe standarte të thjeshta të zgjedhjeve të shkuara ndryshimet të cilat reflektojnë zgjedhjet e rradhës dakort, përfaqësuesi i partisë demokratike. Atëherë bazuar në çfarë u tha në këtë pikë të rendit të ditës miratohet dhe ky Projektakt.

**Vendimi nr.4**

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Albana Ndoci*



*Mbledhje e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
të datës 7.01.2021, ora 17:30*

**Seancë publike e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve**

**Rendi i Ditës:**

**Projektvendim “Për shpalljen e rezultatit të shortit për caktimin e partisë që do të propozojë anëtarin e shtatë të KZAZ-ve në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021”;**

**Pjesëmarrja:**

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Stafi I KQZ: Ylli Merkaj, Ana Tenolli**

**Përfaqësuesi i PD-së**

**Z.I.Celibashi:** Atëherë mirmbrëma të gjithëve, fillojmë seancën publike për shqyrtimin nga komisioneri shtetërorë të këtyre çështjeve. Projektvendim për shpalljen e rezultatit të shortit për caktimin e partisë që do të propozojë anëtarin e 7- të të KZAZ-së, në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25.04.2021. Projektvendimi për miratimin e formatit dhe specifikimeve të vulës të KZAZ-së, të vulës së KQV-së, të vulës së kryetarit të KQV-së dhe të vulës rezervë të KQV-së për zgjedhjet në Kuvendin e Shqipërisë për datën 25.04.2021, dhe pika e 3-të e rendit të ditës është Projektvendimi për miratimin e modeleve të specifikimeve të shenjave dalluese të logjistikës zgjedhore për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë datë 25.04.2021. Pjesmarrës në mbledhje janë vetë përfaqësues të partive politike, në mënyrë të posaçme përfaqësues të Partisë Demokratike, përfaqësues të partive të tjera politike nuk kanë ardhur. Mirë atëherë fillojmë me shqyrtimin dhe çështjeve sipas rendit të ditës. Fillojmë me projektvendimin që ka të bëjë me shpalljen e rezultatit të shortit për caktimin e partisë që do të propozojë anëtarin e 7-të të KZAZ-ve në zgjedhje për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25.04.2021. Ja jap fjalën sekretarit ose nuk e di drejtoresha për

1

**Zbardhi materialin e inçizuar  
Albana Ndoci**



*Mbledhje e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
të datës 7.01.2021, ora 17:30*

të prezantuar për të relatuar mbi Projektaktin.

**Z.Y.Merkaj:** Fillojme me nenin 29 të Kodit Zgjedhorë përcaktohet se anëtari i 7-të propozohet në gjysmën e KZAZ-ve nga partia e parë e selisë parlamentare kurse në gjysmën tjetër propozohet nga partia e parë e opozitës parlamentare. Sipas kriterëve të mëposhtme përzgjedhje rastësore dhe shpërndarje të barabartë në territorin zgjedhorë. Komisioni rregullator me vendimin nr.5 datë 20.11.2020 ka përcaktuar rregullatorin e organizimit të funksionimit të komisionit të zonës të administrimit zgjedhorë. Ku në nenin 4 është përcaktuar procedura e hedhjes së shortit në seancë publike ndërmjet partive kryesore të shumicës parlamentare dhe partisë kryesore të opozitës parlamentare. Në nenin 7-te të këtij vendimi përcaktohet se komisioni i shpalljeve në rezultatin e shortit për caktimin e partisë politike që do pronësoj anëtarin e KZAZ-ve. Në zgjedhjet e përkohën e datës 25.02.2021 partitë politike të cilat do të propozojnë anëtarin e 7-të të Kzaz-ve do të ndahet midis Partisë Demokratike dhe Partisë Socialiste të Shqipërisë, për sa më lart KQZ-ve i propozohet për shqyrtim dhe miratim projektvendimi i mësipërm për të shpallë rezultatet e shortit, për caktimin e partisë e cila do të propozojë antari i 7-të dhe komisioneve të zonave të administrimit zgjedhorë për zgjedhjet për Kvendin e Shqipërisë datë 25.04.2021, faleminderit.

**Z.I.Celibashi:** Mirë faleminderit, kemi ndonjë pyetje diskutim nga përfaqësuesit e partive politike? Nuk ka, mirë vazhdojmë me procedurat e shortit. Nëse nuk kemi ndonje propozim të aspektit teknik të organizimit të shortit? Nuk kemi.

**Z.Y.Merkaj:** Atëherë sipas nenit 4 të vendimit nr.5 të vitit 2008 komisionit rregullator për efekt të shortit zona e administrimit zgjedhor mbajnë emërtim sipas përcaktimit që është në vendimin e komisionit rregullator ndërsa në KZAZ-të dhe

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Albana Ndoci*



*Mbledhje e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
të datës 7.01.2021, ora 17:30*

ZAZ-të nr.8 anëtari 7-të do të propozohet nga një prej partive qe merr pjesë në short ndërsa në pjesën tjetër do të propozohet nga KZAZ-të me nr.çift anëtari i 7-të do të propozohet nga partia tjetër. Emrat e partive pjesëmarrëse në short do të shkruhen në shirita letre të cilat mbyllen në dy gogla në formë dhe me ngjyrë të njejtë dhe vendosen në një enë transparente. Dy shiritat ku janë shënuar KZAZ-të të emërtuara me numër tek dhe KZAZ-të të emërtuara me numër çift mbyllen në dy gogla me formë dhe ngjyrë të njejtë dhe vendosen në enën tjetër transparente. Atëherë nëpunësi i administratës që është goca në fjale tërheq goglat që ndodhen në enën transparente. Atëherë nga rezultati i shortit është Partia Demokratike dhe përfaqësuesi i parë i partisë demokratike do të tërheqi goglën në enën e dytë, atëherë meqë jan dakort që ta tërheqi punonjësi i administratës së KQZ-së. Atëherë në KZAZ-të me numër tek do të jetë e drejta e propozimit është e Partisë Demokratike, ndërsa në KZAZ-të me numër çift të drejtën e propozimit e ka Partia Socialiste e Shqipërisë.

**Z.I.Celibashi:** Ju faleminderit, atëherë sipas rezultatit të shortit e drejta për të propozuar anëtarin e 7-të në KZAZ-të me numër tek, kjo e drjejtë ju takon Partisë Demokratike dhe në KZAZ-të me numër çift e drejta për të propozuar anëtarin e 7-të të KZAZ-së ju takon Partisë Socialiste. Kemi ndonjë gjë tjetër për përfaqësusit e partive deri në këtë pikë? Jo nuk kemi, faleminderit. E mbyllim këtë pikë të rendit të ditës.

**Vendimi nr.5**

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Albana Ndoci*



*Mbledhje e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
të datës 7.01.2021, ora 17:30*

**Seancë publike e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve**

**Rendi i Ditës:**

**Projektvendim “Për miratimin e modeleve dhe specifikimeve të shenjave dalluese të logjistikës zgjedhore për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021”**

**Pjesëmarrja:**

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Stafi i KQZ: Ylli Merkaj, Ana Tenolli**


**Përfaqësues i PD-së.**

**Z.I.Celibashi:** Atëherë mirmbërëma të gjithëve, fillojmë seancën publike për shqyrtimin nga komisioneri shtetërorë të këtyre çështjeve. Projektvendim për shpalljen e rezultatit të shortit për caktimin e partisë që do të propozojë anëtarin e 7-të të KZAZ-së, në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25.04.2021. Projektvendimi për miratimin e formatit dhe specifikimeve të vulës të KZAZ-së, të vulës së KQV-së, të vulës së kryetarit të KQV-së dhe të vulës rezervë të KQV-së për zgjedhjet në Kuvendin e Shqipërisë për datën 25.04.2021, dhe pika e 3-të e rendit të ditës është Projektvendimi për miratimin e modeleve të specifikimeve të shenjave dalluese të logjistikës zgjedhore për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë datë 25.04.2021. Pjesmarrës në mbledhje janë vetë përfaqësues të partive politike, në mënyrë të posaçme përfaqësues të Partisë Demokratike, përfaqësues të partive të tjera politike nuk kanë ardhur. Mirë atëherë fillojmë me shqyrtimin dhe çështjeve sipas rendit të ditës. të prezantuar për të relatuar mbi Projekt Aktin.

Kalojmë tek pika e fundit e rendit të ditës, që ka të bëjë me miratimin e modeleve specifikuese të shenjave dalluese të logjistikës zgjedhore për zgjedhjet për

1

**Zbardhi materialin e inçizuar  
Albana Ndoci**



*Mbledhje e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
të datës 7.01.2021, ora 17:30*

Kuvendin e Shqipërisë datë 25.04.2021.

**Z.Y.Merkaj:** Referohemi nenit 99 të Kodit Zgjedhorë KQZ-ve dërgon në selitë e zonave të administrimit zgjedhorë për çdo qendër votimi materialet zgjedhore dhe shkrimet e tjera të nevojshme për procesin e votimit. Vendosi e shenjave dalluese në fleta më vete, të ndërtesave ku jashtë KZAZ-ve në qendrat e votimit dhe vendi i numërimit të votave i shërben identifikimit të vendodhjes së ndërtesave si dhe vëndet ku do të kryhet administratimi zgjedhorë. Modelet etiketat e kutisë së votimit, kutisë së materialeve i shërbejnë organizimit të mirë të punës dhe orjentimit të zgjedhësve në qendrat e votimit. Kutia e materialeve krahas etiketës identifikuese ka në faqen ballore dhe një etiketë kujtese e cila shërben për ti ardhur në ndihmë komisionerit të qendrës së votimit. Për sa më sipër neni propozohet ti paraqitet për shqyrtim dhe miratim projektvendimit të mësipërm Komisionerit të Shtetit të Zgjedhjeve brenda kompetencave që ka. Bashkëlidhur kemi dhe projektvendimin si dhe shenjat dalluese, faleminderit.

**Z.I.Celibashi:** Dakord, faleminderit tani lidhur me këtë projektakt për dijeninë edhe të përfaqësuesve të partive politike që janë prezent por edhe për të tjerët që mund ta marrin këtë informacion. Ideja është që të gjitha këto modelet dhe shenjat të jenë sa më të thjeshta dhe sa më thjeshtë të identifikueshme, jo vetëm nga punonjësit e administratës zgjedhore të nivelit të dytë dhe të tretë, por dhe për subjektet zgjedhore, vëzhguesit apo dhe votuesit. Për pjesën tjetër në përgjithsi është respektuar tradita e zgjedhjeve të shkuara dhe nuk është se ka ndryshime thelbësore të mëdha. Kemi ndonjë diskutim? Mirë faleminderit, atëherë miratohet dhe ky Projektakt. Meqenëse nuk kemi çështje të tjera në rendin e ditës mbledhjen e deklaroj të mbyllur. Faleminderit dhe natën e mirë. **Vendimi nr.6**

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Albana Ndoci*

